



Mali i Zi / Crna Gora
Komuna e Tuzit / Opština Tuzi

Sekretariati për vetëqeverisje lokale
Sekretarijat za lokalnu samoupravu

Nr./Br. 04-100/24-400/11

Rruga Tuz nr. 1 , nr. 44
Ulica Tuzi br.1 , br. 44

+382 20 875 167
veteqeverisje.lokale@tuzi.org.me
Tuz – Tuzi, 06.06.2024. godine

LAJMËRIM

për datën, vendin, kohën dhe mënyrën e kontrollit të kompetencave, njohurive dhe aftësive për kryerjen e detyrave të Sekretarit të Kuvendit të Komunës së Tuzit.

Të nderuar,

Ju njoftojmë se procedura për kontrollin e kompetencave, njohurive dhe aftësive do të kryhet sipas Konkursit Publik me numër 04-100/24-1943/4 të datës 10.04.2024, të cilin e ka shpallur Sekretariati për Vetëqeverisjen Lokale me datën 10.04.2024., për nevojat e Shërbimit të Kuvendit të Komunës së Tuzit për vendin e punës sekretar i Kuvendit të Komunës së Tuzit, që do të mbahet më 19.06.2024., (e mërkurë) në orën 09:30, në ambientet e Komunës së Tuzit.

Verifikimi i kompetencave, njohurive dhe aftësive të kandidatëve që plotësojnë kushtet e konkursit publik për plotësimin e vendit të punës në kategorinë e personelit të lartë drejtues fillon me testimin me shkrim.

Testimi në formë të shkruar nënkupton përgatitjen e një punimi me shkrim, i cili përmban një pasqyrë të prioriteteve dhe propozimeve për përmirësimin e procesit të punës, gjegjësisht gjendjen e punëve në fushën e punës për të cilën kandidati caktohet apo emërohet.

Përgatitja e punës me shkrim zgjat jo më shumë se 60 minuta.

Kandidati që ka marrë më shumë se 50% në testin me shkrim mund të marrë pjesë në intervistën e strukturuar.

Në intervistën e strukturuar, kandidati prezanton punimin me shkrim deri në 15 minuta, duke e bërë këtë para të gjithë anëtarëve të Komisionit, dhe më pas kandidati i shtohen pyetje.

Vetëm kandidatët nga lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet e konkursit publik mund të marrin pjesë në procedurën e kontrollit të kompetencave, njohurive dhe aftësive:

Nermin Alibašić

Theksojmë se është e nevojshme që kandidatët përpara fillimit të testimit me shkrim, për të vërtetuar identitetin e tyre, të pajisin Komisionin me një dokument identiteti (me foto).

SEKRETARE,

